



"BREGDETI ASSOCIATION" THE COAST

Defending Property, Pursuing Justice

P.O. Box 258 • Tirana,
ALBANIA

E-mail: shoqatabregdeti@yahoo.com Phone: 0355 693455112

Tiranë, me 31.10.2012

Shkëlqesia juaj Ambasador

Duke ju falenderuar për perpjekjet tuaja për të kufizuar korrupsionin në rritje në Shqipëri ne kërkojmë solidaritetin tuaj për të ndaluar korrupsionin pushtetar me pronat. Për këtë problem thelbësor ju parashtrojmë sa vijon: Është i njohur fakti se Qeveria Shqiptare nuk po e respekton të drejtën e pronës dhe shkel Kushtetutën ne fuqi. Ne ju kemi informuar disa herë se situata e anarkisë së pronës të organizuar pas vitit 1991, me kalimin e viteve, në vend që të përmiresohet po përkeqesohet.

Transferimin e paligjshëm të pronave direkt dhe indirekt po e ndihmojnë dhe institucionet ndërkombëtare dhe kjo është rrugë e gabuar që nuk të çon në demokraci. Përveç kërkesës tuaj për zgjedhje të lira dhe të ndershme, ne besojmë se që kjo çështje që është një nga 12 kërkesat e Këshillit të Europës, që të mund të zgjidhet drejtë, ka të domosdoshme që shtetet antare të Bashkimit Europian të kushtëzojnë marrëditet bilaterale me autoritetet shqiptare me respektimin e të drejtës së pronës si dhe të miratoni një monitorim ndërkombëtar mbi Qeverinë Shqiptare deri në zgjidhjen e këtij problemi thelbësor.

Ju dërgojmë bashkangjitur kërkesat tona drejtuar Presidentit të Bankës Botërore (letrat tona të datës 28 Shtator dhe 25 tetor 2012 si dhe përgjigjen e Bankës Botërore të datës 11 Tetor 2012).

Qendrimi i Bankës Botërore është një shembull i keq, që ilustron se si institucionet ndërkombëtare, keqpërdorjnë fondet e komunitetit ndërkombëtar dhe me ose pa ndërgjegje, konsolidojnë kleptokracinë. Në rastin konkret më e keqja është se specialistët e Bankës Botërore, veç gabimeve të deritanishme, edhe pas sqarimeve që ju kemi dhënë, insistojnë në justifikimin e korrupsionit dhe mohimin e të drejtës së pronës. Kjo është ekuivalent me genocid dhe çkombëtarizim të popullatës autoktone.

Ne shpresojmë të kemi mirekuptimin dhe bashkëpunimin tuaj drejt zgjidhjes së çështjes së kthimit të pronës pronarëve të ligjshëm dhe trajtimit normal e korrekt të pronave në Shqipëri.

Me respekt
Kryetari Shoqates Bregdeti
Dr. Niko Nesturi